

## V E N D I M

**NR.1055, DATË 22.12.2010**

### PËR VENDOSJEN E Oponencës Teknike Për Projektet e Veprave të Ndërtimit

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, 6, 8 e 18, të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

#### V E N D O S I:

1. Për të gjitha projektet e veprave të ndërtimit, që realizohen në territorin e Republikës së Shqipërisë nga subjekte fizike dhe juridike, vendas ose të huaj, për të cilat vlera e preventivuar e punimeve të ndërtimit është jo më pak se 100 000 000 (njëqind milionë) lekë, të bëhet oponencë teknike.

2. Për të gjitha projektet e veprave të ndërtimit, oponencia teknike do të bëhet nga subjekte publike studimore/shkencore, të miratuara nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit.

3. Të gjitha projektet e veprave të ndërtimit, të përmendura në pikën 1, të këtij vendimi, nuk mund të miratohen nga organet kompetente pa kryerjen e oponencës teknike. Oponencia teknike është pjesë e dokumentacionit teknik të projektit.

4. Kërkesa për oponencë teknike bëhet nga investitori. Me miratimin e kërkesës, palët lidhin një aktmarrëveshje ndërmjet tyre, kushtet e së cilës miratohen nga ministri i Punëve Publike dhe Transportit.

5. Tarifat e oponencës teknike të projekteve të veprave të ndërtimit të zbatohen duke i referuar aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

6. Ngarkohen ministritë, institucionet qendrore dhe vendore, si dhe të gjitha organet e tjera investitore për zbatimin e këtij vendimi.

7. Vendimi nr.363, datë 18.7.2002, i Këshillit të Ministrave, "Për vendosjen e oponencës teknike për projektet e ndërtimit të objekteve", i ndryshuar, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".